



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 66, datë 26.05.2017**

**MBI  
MIRATIMIN E NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT  
NDËRMJET AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE DHE  
FAKULTETIT TË BIZNESIT, UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 18, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e Nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Fakultetit të Biznesit, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv për nënshkrimin e kësaj marrëveshje.
3. Ngarkohet Drejtorja e Zhvillimeve Strategjike, Statistikës dhe Medias, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin KOÇI**



## **MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

*Ndërmjet*

**FAKULTETIT TË BIZNESIT**

**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**

*dhe*

**AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE**

## **FAKULTETI I BIZNESIT**

**dhe**

## **AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Duke synuar zhvillimin e bashkëpunimit dhe partneritetit dypalësh në kuadër të transmetimit të dijeve mbi aktivitetin dhe mbikëqyrjen e tregut financiar përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve nga institucionet e arsimit të lartë;

### **BIEN DAKORD:**

Të lidhin këtë marrëveshje si më poshtë:

#### **NENI 1**

#### **Objekti i marrëveshjes**

Kjo marrëveshje synon sigurimin e bashkëpunimit midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe Fakultetit të Biznesit, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës (FB UAMD) (me poshtë, “palët”) lidhur me përmirësimin dhe pasurimin e përmbajtjes së programeve të studimit me koncepte dhe analiza të mënyrës së funksionimit dhe të mbikëqyrjes së tregut financiar, në kuadër të bashkërendimit të përmbajtjes teorike me aspektet praktike për një përgatitje sa më cilësore dhe profesionale të studentëve.

#### **NENI 2**

#### **Parimi dhe vlera e bashkëpunimit**

Dy institucionet angazhohen të punojnë së bashku në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe frymën e mirëkuptimit, për të realizuar interesat reciproke që synon kjo marrëveshje.

### **NENI 3** **Baza ligjore**

Kjo marrëveshje bazohet në Ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar.

### **NENI 4** **Përfaqësuesit e palëve**

Në këtë marrëveshje, palët do të përfaqësohen nga:

- **Znj. Azeta TARTARAJ, Dekan i Fakultetit të Biznesit, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës,**
- **Z. Ervin KOÇI, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.**

### **NENI 5** **Sfera e bashkëpunimit**

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi me interes të dyanshëm:

#### **1. Palët angazhohen për:**

- a. Përcaktimin konkret dhe rishikimin e rregullt të drejtimeve të bashkëpunimit;
- b. Informimin në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme të palës tjetër për përmbushjen e angazhimeve në këtë marrëveshje dhe për zhvillimet në secilin institucion, që paraqesin interes për aktivitetin institucional të palës tjetër;
- c. Shkëmbimin e materialeve dhe rezultateve të punës studimore dhe shkencore të lidhura me aktivitetin e FB UAMD dhe AMF-së;
- d. Nxitjen, përfshirjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të përbashkëta, përfshirë këtu edhe projekte të ndryshme me dhe pa donatorë të huaj;
- e. Shkëmbimin ose punën e përbashkët të ekspertëve / burimeve njerëzore të dy institucioneve, me qëllim përmbushjen e funksioneve të secilit institucion;
- f. Identifikimin e mekanizmave të nxitjes së punës kërkimore shkencore të universitetit dhe zbatimit praktik të tyre në punën e AMF-së;

- g. Organizimin e konferencave të përbashkëta, trajnimeve, intershipeve, leksioneve të hapura, seminareve, praktikave mësimore apo takimeve. Dhënien e informacionit në lidhje me mbrojtjen e konsumatorëve, ruajtjen dhe stabilitetin e transparencës në fushën e sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensioneve private suplementare.

## **2. Fakulteti i Biznesit, UAMD angazhohet:**

- a. Të mundësojë shfrytëzimin, në kushte të përshtatshme pune, të mjediseve të fakultetit të biznesit nga ana e AMF-së, për veprimtari të përbashkëta ose që i organizon vetë AMF, për sa kohë që ato janë në pajtim me vetë veprimtarinë e Fakultetit të Biznesit dhe është njoftuar paraprakisht;
- b. Identifikimin e mekanizmave të nxitjes së punës kërkimore shkencore të universitetit dhe zbatimit praktik të tyre në punën e AMF-së;
- c. Të respektojë kërkesat lidhur me konfidencialitetin e informacionit dhe të dhënave që akseson në kuadër të kësaj marrëveshjeje, sipas nenit 4.

## **3. AMF angazhohet:**

- a. Për të mundësuar bashkëudhëheqjen e studimeve dhe kërkimit shkencor të studentëve të ciklit të dytë dhe të tretë të doktoraturës kur ato lidhen me fushën e veprimtarisë së AMF-së;
- b. Për vënien në dispozicion për studentët ekselentë të Masterit Shkencor dhe Profesional dhe studentët e doktoraturës, të materialeve të ndryshme burimore si analiza, metodologji, dokumente dhe mundësimin e shfrytëzimit të arkivës, bibliotekës, sistemeve teknologjike, në përputhje me rregullat përkatëse;
- c. Për mbështetjen e punës së studentëve ekselentë të Masterit Shkencor dhe Profesional dhe studentët e të doktoraturës, në drejtim të lehtësimit të realizimit të intervistave, pyetësorëve, vrojtimeve me pjesëmarrës të tregut financiar që rregullohen nga AMF;
- d. Për të mundësuar zhvillimin e praktikave institucionale (stazhe, internshipe, etj.) të studentëve të Fakultetit të Biznesit, në përputhje me kapacitetet ekzistuese dhe planifikimit/njoftimit paraprak;
- e. Për dhënien e konsulencës lidhur me përmirësimin e kurrikulave të programeve master ekzistuese të studimit, hapjen e programeve të reja të studimit me fokus veprimtarinë e tregut financiar dhe të mënyrës së mbikëqyrjes së tij, me qëllim përgatitjen e kapaciteteve cilësore dhe profesionale për tregun financiar nën juridiksionin e AMF-së.

## **NENI 6**

### **Trajtimi i informacionit dhe të dhënave konfidenciale**

1. Fakulteti i Biznesit dhe stafi i tij, duhet të trajtojë çdo informacion apo të dhënë që nuk është publike dhe që e akseson në kuadër të kësaj marrëveshjeje, në përputhje me rregulloren nr. 114, datë 11.09.2008, "Për Konfidencialitetin në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" si dhe normat e konfidencialitetit të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
2. Fakulteti i Biznesit dhe stafi i tij do ta përdorë informacionin e marrë vetëm me qëllim të kësaj marrëveshjeje.
3. Fakulteti i Biznesit dhe stafi i tij nuk ka të drejtë të vërë në dispozicion të ndonjë pale të tretë informacionin dhe të dhënat që ka marrë sipas kësaj marrëveshjeje, pa marrë më parë miratimin paraprak me shkrim (shkresë, postë elektronike) të AMF-së.
4. Fakulteti i Biznesit dhe stafi i tij, kërkojnë paraprakisht orientim nga ana e AMF-së për rastet e paqartësisë lidhur me natyrën dhe trajtimin e informacionit dhe të dhënave, që kanë aksesuar në kuadër të kësaj marrëveshjeje.

## **NENI 7**

### **Pronësia Intelektuale**

Kur si rezultat i bashkëveprimeve të kryera në përputhje me këtë Marrëveshje, realizohen produkte që janë objekt i së drejtës mbi pronësinë intelektuale, ato do të trajtohen sipas legjislacionit në fuqi.

## **NENI 8**

### **Komunikimi**

Palët angazhohen të mbajnë komunikim të vazhdueshëm në të gjitha nivelet. Me qëllim përmbushjen e objektivave të kësaj marrëveshjeje, secila palë do të caktojë një person si bashkëkoordinues për komunikimin midis tyre dhe përcjelljen e problematikave sipas rastit. Për aq sa është e mundur, komunikimi do të kryhet përmes personave të kontaktit dhe me shkrim (shkresë, postë elektronike). Personat e kontaktit për zbatimin e Marrëveshjes përcaktohen në aneksin 1 bashkëlidhur.

### **NENI 9**

#### **Kufizimet e marrëveshjes**

1. Të dy palët bien dakord që realizimi i veprimtarive me interes të përbashkët të kryhet në varësi të përparësive, planifikimit paraprak, burimeve dhe potencialit të disponueshëm nga secili institucion.
2. Për çdo veprimtari tjetër, që përputhet me frymën e kësaj marrëveshjeje, palët kanë të drejtë të konkludojnë mbi mënyrën e realizimit të bashkëpunimit.

### **NENI 10**

#### **Ndryshimi, amendimi dhe revokimi i marrëveshjes**

Çdo nen i kësaj marrëveshjeje mund të ndryshohet, të amendohet ose të revokohet në çdo kohë, pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet dy institucioneve.

### **NENI 11**

#### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje, do të zgjidhet me mirëkuptim dhe bashkëpunim mes palëve.

### **NENI 12**

#### **Hyrja në Fuqi**

Kjo marrëveshje hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të përfaqësuesve të palëve, dhe do t'i shtrijë efektet për një periudhë kohe të pakufizuar. Kjo marrëveshje hartohet në dy kopje dhe secila nga palët mban një kopje në origjinal.

NËNSHKRUAR sot, më datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2017, në Durrës.

**Për Fakultetin e Biznesit**  
**DEKAN**  
**Azeta TARTARAJ**

**Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare**  
**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin KOÇI**

## ANEKS 1

Personi i kontaktit për **Fakultetin e Biznesit:**

**Ada ALIAJ**

Përgjegjëse e Departamentit të Financë - Kontabilitetit

Adresa: Kampusi Universitar, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

Tel: 069 25 35 919

Fax: -

E-mail: [aliajada@yahoo.com](mailto:aliajada@yahoo.com)

Personi i kontaktit për **Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare:**

**Ornela KULLOLLI**

Edukimi Financiar

Adresa: Rruga "Dora D'istria" Nr. 10, P.O. Box 8363, Tiranë, Albania.

Tel: +355 (04) 2257560

Fax: +355 (04) 2250686

Email: [okullolli@amf.gov.al](mailto:okullolli@amf.gov.al)